

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E GLOGOCIT
MUNICIPALITY OF GLOGOC

Nr. 070-71455
01 MS
Gll. 04.12.2018



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo za Rad i Socijalnu Zaštitu
Ministry of Labour and Social Welfare

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE Ministarstvo Rad i Socijalne Zaštite Ministry of Labour and Social Welfare	
Agj. Org. Ag. detyruesha Ag. Unit. No. d'Emploi No. d'attribution No. pages	No. Prot. Prot. No. Data Date Prishtinë-Prishtina
05	585 11.12.18

Komuna e Glllogocit
Opština Glogovac
Municipality of Glllogoc

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR PARANDALIMIN DHE ELIMINIMIN E FORMAVE TË RËNDA TË PUNËS SË FËMIJËVE

NDËRMJET

MINISTRISË SË PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE (Në tekstin e mëtejshëm "MPMS")

DHE

KOMUNËS SË GLLOGOCIT (Në tekstin e mëtejshëm "Komuna")

(Në vijim "Palët nënshkruese")

Hyrja:

Me qëllim për të ndihmuar dhe dhënë mbështetje për çështjet e interesit të përbashkët të palëve në lidhje me arritjen e objektivave për mbrojtjen e fëmijëve nga punët e rënda dhe të rrezikshme, dhe duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2013 për Eliminimin dhe Ndalimin e Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve, të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas nenit 2 pika 1.8, nenit 6 pikat 1, 2, 3, nenit 8 dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr. 10/87 të Komitetit të Kosovës për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve.

Për këto çështje, palët vendosën të kenë marrëdhënie bashkëpunimi dhe për këtë qëllim nënshkruhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimit:

R. L

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi, ka për qëllim të rregullojë dhe të koordinojë aktivitete të institucioneve në nivelin qendror dhe lokal për mbrojtjen e fëmijëve nga eksploatimi ekonomik dhe nga kryerja e punëve që pengojnë edukimin e tyre ose që janë të dëmshme për shëndetin dhe zhvillimin psiko-fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror të tyre, si dhe parandalimin dhe eliminimin efektiv të punës së fëmijëve, me fokus të veçanta ndaj formave të rënda dhe të rrezikshme të punës së tyre.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi përmban kornizën e punës si dhe përgjegjësitë e palëve në lidhje me krijimin e mundësive për veprimtaritë e planifikuara dhe të bashkërenduara me miratim paraprak ndërmjet palëve, për parandalimin dhe eliminimin e punës së rëndë të fëmijëve, siç janë:

- 1.1. Krijimi i Komitetit Lokal të Veprimit;
- 1.2. Shkëmbimi i informacioneve;
- 1.3. Trajnime të përbashkëta profesionale për anëtarët e KLV-ve;
- 1.4. Takime të rregullta periodike për çështjet me interes të përbashkët;
- 1.5. Raportimi i zbatimit të aktiviteteve dhe progresit të arritur.

Neni 3

Baza e bashkëpunimit

Bazë për realizimin e kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi është legjislacioni i zbatueshëm i Republikës së Kosovës.

Neni 4

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

1. Përgjegjësitë e MPMS-së janë si vijon:
 - 1.1. Zhvillon politika sociale dhe harton legjislacionin për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare;
 - 1.2. Harton akte normative, standardet minimale, planet strategjike për shërbime sociale me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të punëve të rënda dhe të rrezikshme të fëmijëve;
 - 1.3. Bashkëpunon me agjencitë ndërkombëtare jo qeveritare në mënyrë që të promovojë zhvillimin dhe zbatimin koherent të politikave të mirëqenies sociale;

R. L

1.4. Ofron ndihmë dhe mbështetje profesionale, për nevojat e Komitetit Lokal të Veprimit;

1.5. Në bashkëpunim me partnerët e tjerë qendror dhe lokal, do të ofrojë mbështetje në ngritjen e kapaciteteve të stafit të QPS-ve dhe partnerëve të tjerë, për zbatimin e aktiviteteve për parandalimin dhe eliminimin e punëve të rënda të fëmijëve;

1.6. Mbledh të dhënat dhe statistikën për punën e fëmijëve, përmes Qendrës për Punë Sociale me qëllim të hartimit të raportit vjetor për Qeverinë.

Neni 5

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës

1. Përgjegjësitë e Komunës janë si vijon:

1.1. Sigurimi i ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare nëpërmjet Drejtorisë Komunale përgjegjëse brenda territorit të saj, sipas legjislacionit në fuqi dhe standardeve të miratuara;

1.2. Drejtoria Komunale përgjegjëse udhëheq me Komitetin Lokal të Veprimit, në koordinim të ngushtë me Qendrën për Punë Sociale;

1.3. Kryetari i Komunës aprovon termat e referencës për Komitetin Lokal të Veprimit për parandalimin dhe eliminimin e punëve të rënda të fëmijëve;

1.4. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për themelimin e Komitetit Lokal të Veprimit, për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe termat e referencës për Komitetin Lokal të Veprimit për parandalimin dhe eliminimin e punëve të rënda të fëmijëve;

1.5. Drejtoria Komunale përgjegjëse, ka obligim të monitorojë aktivitetet e KLV-ve dhe të raportojë te kryetari i Komunës dhe Departamenti i Politikave Sociale dhe të Familjes/MPMS për zbatimin e aktiviteteve dhe punën e Komiteteve Lokale të Veprimit;

1.6. Institucioni udhëheqës i KLV-ve raporton mbi baza mujore tek Qendra për Punë Sociale, për numrin e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda dhe të rrezikshme për fëmijët;

1.7. Qendrat për Punë Sociale, janë përgjegjëse për regjistrimin e të dhënave dhe informatave në bazën e shënimeve për shërbime sociale;

1.8. Qendra për Punë Sociale, raporton te Departamenti i Politikave Sociale dhe i Familjes mbi baza gjashtëmujore për numrin e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda dhe të rrezikshme.

R. L

1.9. Tryeza për Menaxhimin e Rasteve të themeluara në nivel komunal do të trajtojë të gjitha rastet që janë në rrezik të mesëm ose lartë të fëmijëve të përfshirë në punë.

Neni 6 **Komiteti Lokal i Veprimit**

1. Komiteti Lokal i Veprimit, në përbërjen e tij duhet të përfshijë përfaqësues të disa institucionet lokale, siç janë:

- 1.1. Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
Hanumshahe Hajdini
- 1.2. Drejtoria Komunale e Arsimit; Hazir Elshani
- 1.3. Drejtoria Komunale e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
Ahmet Ahmeti
- 1.4. Drejtoria Komunale e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Skender Hasi
- 1.5. Qendra për Punë Sociale; Vlorian Meha
- 1.6. Njësia për Mbrojtjen dhe Ndihmë Viktimave; Kadire Tahiraj
- 1.7. Shërbimi Sprovues - Zyrtari i shërbimit sprovues; Heroina Bogaj .
- 1.8. Policia e Kosovës në komunitet; Hysen Thaqi,
- 1.9. Policia e Kosovës - Njësia kundër dhunës në familje; Nazmie Rrukiqi
- 1.10. Zyra e Punësimit & Qendra e Aftësimit Profesional; Ragip Dervishi
- 1.12. OJQ-të (aktive në mbrojtjen e fëmijëve); Violeta Baleci
- 1.13. Këshilli i Veprimit Rinor; Alberie Makolli
- 1.14. Këshilli Komunal Prind-arsimtar; Xhavit Bytyqi
- 1.15. Asambleja Komunale e Fëmijëve; **nuk ka akoma asamble te themeluar edhe pse kemi rregulloren te aprovuar nga kuvendi i komunes, besojmë qe shum shpejt edhe kjo qeshtje do te plotesohet ne vazhdim.**
- 1.16. Tryeza për Menaxhimin e Rasteve, ekipi komunal per TMR(Vlorian Meha, Hazir Elshani, Nazmie Rrukiqi, Naim Bilalli-nga qendra e TMR)

Neni 7 **Zgjidhjet e mosmarrëveshjeve**

1. Në rast se paraqiten paqartësi dhe mos pajtime në mes të palëve të përfshira në këtë Marrëveshje, ato do të zgjidhen përmes bisedimeve.

2. Nëse tentativat për zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjeve nuk kanë sukses, secila nga palët mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje. Njoftimi për ndërprerjen e Marrëveshjes duhet t'i dërgohet palës tjetër me shkrim, së paku një muaj para ndërprerjes efektive të saj.

R.L

Neni 8
Modifikimi i marrëveshjes apo ndërprerja e saj


1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të modifikohet apo të shfuqizohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me hyrjen në fuqi të ndonjë ligji, fushëveprimi i të cilit prek ndonjë nga pikat e kësaj Marrëveshjeje, apo aktet e tjera nënligjore dispozitat e të cilave janë në kundërshtim me këtë Marrëveshje.
2. Çdo ndryshim eventual i kësaj Marrëveshjeje do të shtohet si aneks dhe do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga përfaqësuesit e institucioneve zbatuese të saj.
3. Secila nga palët mund të tërhiqet brenda tridhjetë (30) ditësh pas paralajmërimit me shkrim.
4. Koha e paralajmërimit do të merret data e pranimi të letrës paralajmëruese.

Neni 9
Hyrja në fuqi


1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet më datën 04/12 2018, në Prishtinë, Republika e Kosovës, në dy (2) ekzemplarë origjinal, nga një për secilën palë nënshkruese.
2. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dyja palët.

PALËT NËNSHKRUESE

Për: Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale
z. Skender Rexica / Ministër



Për: Komunën e Glogocit
z. Ramiz Lladrovci / Kryetar



Prishtinë, 2018